



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr.7731/5201(31010-01423-86-2015) Regjistri Themeltar
Datë 17.03.2015 regjistrimi

Nr.3977(86-2016-956) Vendimi
Datë 21.11.2016

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Apelit e përbërë nga gjyqtarët:

GJYQTAR : Kastriot SELITA

GJYQTARE : Bernina KONDI

GJYQTARE : Altina NASUFI

Asistuar nga sekretare gjyqësore [REDACTED], në Tiranë në datë 21.11.2016 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen administrative me nr. 7731/5201(31010-01423-86-2015) rregjistri themeltar, me palë ndërgjyqëse:

PADITËS :

[REDACTED], biri i [REDACTED] dhe [REDACTED] i dtl.
[REDACTED] lindur ne [REDACTED] dhe banues ne [REDACTED]

TË PADITUR :

Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve te Transportit Rrugor Tirane.
Drejtoria Rajonale e Sherbimeve te Transportit Rrugor Durrës.

PERSON I TRETË:

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

OBJEKTI :

- 1.Shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ, vendim nr.245 datë 12.12.2013 të Drejtorit të Pergjithshëm të Drejtorisë së Pergjithshme të Sherbimeve te Transportit Rrugor Tirane.
- 2.Detyrimi i pales se paditur te me ktheje ne vendin e meparshem te punes.
- 3.Detyrimi i pales se paditur te me demshperbleje me pagesen e nje viti pune per shkak te zgjidhjes se kontrates se marredhenies se punes pa shkaqe te arsyeshme (motiv abuziv).

BAZA LIGJORE:

Neni 18 i Kushtetutes se Republikes se Shqiperise.
Direktiva 2000/78 e BE, ratifikuar nga Parlamenti i Shqiperise. Ligji nr. 10221 date 04.02.2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi".
Nenet 31,32,36,41,42,53,54,153,154 e vijues te K.Pr.Civile. Kodi i Procedurave Administrative.

Nenet 2,3,7,11,14,15,16,17,18,21,25,26,32,35,36,37 e vijues te Ligjit nr.49/2012 date 03.05.2012. "Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreveshjeve Administrative". Nenet 146/1/c,146/3 ,148 dhe 153 e vijues te K.Punes.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës me vendimin nr. 46 datë 21.01.2015 ka vendosur:

- Rrëzimin e kërkesë padisë.
- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse.
- Kundër këtij vendimi lejohet brenda 15 ditëve në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala paditëse [REDACTED], duke parashtruar këto shkaqe për ndryshimin e Vendimit datë 21.01.2015 dhe pranimin e padisë:

- Kontrata e punes eshte zgjidhur ne menyre te menjehershme dhe pa shkaqe te arsyeshme nga i padituri.Ne baze te nenit 146 te Kodit te Punes paditesi duhet te demshperblehet me nje vit page nga i padituri.
- Duke analizuar te gjitha provat, shkaqet, rrethanat e pushimit tim nga puna, pa shkaqe te justifikuara dhe te arsyshme, pa respektuar proceduren e zgjidhjes se kontrates, dhe duke patur parasysh arsimimin, moshen, performancen ne pune, vitet e punes, ne krahasim me punonjesit e tjere te sektorit te lejeve te drejtimit te ndodhur ne rethana te njejta me mua, duke me trajtuar ne menyre te pabarabarte, per te gezuar te drejta e detyrime te barabarta, eshte ne menyre te qarte pushim nga puna per shkak te bindjeve te mija politike.
- Kerkesepadia e pare ka qene bere nga avokat i cili ka kerkuar vetem demshperblim vetem per largimin nga detyra ne menyre te menjehershme.Padia e pare me kete kerkesepadi ka ndryshime , pasi shkaku ligjor eshte i ndryshem.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë në respektim të kërkesave ligjore të neneve 46 dhe 48 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshuar, ka vendosur pranimin e ankimit të palës paditëse në gjykim.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

në dhomë këshillimi, pasi dëgjoi relatimin e gjyqtares **Bernina Kondi**, shqyrtoi të gjitha aktet shkresore dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

I.Rrethanat e çështjes:

Nga tërësia e akteve shkresore, provë në dosjen gjyqësore rezulton e provuar se pala paditëse Paditesi ka filluar pune prane te padit ne date 24.10.2009 me detyren "Inspektor i Kontrollit Rrugor" ne Sektori Kontrollit Rrugor, ne Drejtorine Rajonale ne Durres.

Midis paditesit dhe te paditurit ne date 24.10.2009 është lidhur kontrata individuale e punes me afat te pacaktuar, ku jane percaktuar te drejtat dhe detyrimet e paleve sipas permbajtjes te kontrates. Kontrata e punes eshte lidhur në mbeshtetje te Ligjit Nr. 7961 date 12.07.1995 "Kodi i Punes i Republiqe Shqiperise".

Me daten, 06.12.2013 pas njoftimit paraprak jane zhvilluar bisedime me punedhenesin per nderprerjen e marredhenieve te punes, gje e cila provohet ng procesverbali i mbajtur ne po ate date. Ne kete takim paditesi eshte vene ne dijeni se marredhia e tij punes me te paditurin do te perfundoje per shkak te organizimit te ri të punes ne ate Institucion. Ne kete procesverbal, provohet se ne bisedimet e zhvillura me perfaqesuesit e punedhenesit paditesi ka kundershuar nderprerjen e marredhenieve te punes.

Ne date 12.12.2013 nga Drejtuesi i Institucionit(Drejtori i Pergjitheshem) eshte marre vendimi nr.245 me ane te te cilit eshte vendosur qe paditesi ...te nderprese marredheniet e punes me DPSHTRR per arsye te riorganizimit te ketij sektori me qellim rritjen e performances se institucionit, ti paguhet afati i njoftimit ne mbeshtetje te Nenit 143, te Kodit te PuneTe llogaritet nga D.R.Durres dhe t'i akordohet shperblimiper vjetersineper ne baze te nenit 145 te Kodit te Punes....

Paditesi ka paraqitur kerkese padi ne Gjykatën Administrative ne Durres ne date 31.03.2014 me objekt te kerkese padise: Shfuqizim të vendimit nr.245 datë 12.12.2013 si dhe dëmshpërblimet përkatëse për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës. Në përfundim të këtij gjykimi, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës ka vendosur :” Rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj”. Më pas paditësi i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi, duke pretenduar se zgjidhja e marrëdhënies së tij të punës është bërë për shkaqe abuzive.

II.Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

Gjykata ka rrëzuar padinë me argumentimin si vijon:

Gjykata konstaton se jemi para gjese se gjykuar per arsye se paditësi ka paraqitur kerkesepadi ne kete gjykate me date 31.03.2014, Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Durres me vendim nr.554 06.05.2014 ka vendosur rrezimin e padise,vendim i cili ka marre forme te prerë më date 21.05.2014.

Ne baze te nenit 451/a te K.Pr.Civile vendimi qe ka mare forme te prerë dhe ka zgjidhur nje konflikt i cili nuk mund te gjykohet perseri.

Nga shqyrtimi i akteve te dosjes me nr.Vendimi 554 date 06.05.2014: rezulton se ne kerkesepadine e paraqitur ne date 31.03.2014 nga paditesi ne bazen ligjore te kerkesepadise jane shenuar dhe nenet 146 te K.Pune, të cilat paditesi i ka shtjelluar edhe ne permbajtjen e kerkesepadise.

Objekti dhe permbajtja si dhe shkakut ligjor i kerkesepadise te paraqitur paditesi me date 13.06.2014 jane te njejta me objektin, permbajtjen dhe shkakut ligjor ne kerkepadine te paraqitur nga ky padites me date 31.03.2014. Pavaresisht nga percaktimet qe i jep paditesi, i cili pretendon se kemi bejme me nje kerkesepadi te re, gjykata konstaton qe objekti i kerkesepadise së dyte eshte i njejte me objektin e percaktuar ne kerkesepadine e pare, pasi ne te dy rastet paditesi ka pretenduar qe kontrata e punes i eshte zgjidhur per shkaqe paarsyeshme.

Pavaresisht nga shkaku ligjor qe i jep paditesi ne padine e dyte, perderisa jemi ne kushtet e maredhenieje te punes shkaku ligjor i kerkesepadise eshte ne 146 i K.Punes, qe percakton rastet e diskriminimit ne keto maredhenie.

Sa me siper gjykata konstaton qe jemi para "gjese se gjykuar" pasi ky konflikt eshte zgjidhur me pare me nje vendim te formes se prere qe eshte vendin nr.554 date 06.05.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

III.Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:

Gjykata kryesisht konstatoi se çështja përbën lëndë juridiksioni gjyqësor dhe se ajo ka kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykimit të saj bazuar në nenet 7 dhe 10 të ligjit nr.49/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*" i ndryshuar dhe duke iu referuar për zbatim Vendimit Njihësues Administrativ të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me nr. 3 datë 06.12.2013.

Në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së ankimit, sikurse ka vlerësuar drejt edhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit konstaton se ankimi është paraqitur konform kërkesave ligjore të neneve 44, 45 dhe 46 të ligjit nr. 49/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", i ndryshuar brenda afatit ligjor, në respektim të formës dhe përmbajtjes së kërkuar nga neni 454 i Kodit të Proçedurës Civile, para gjykatës kompetente, nga subjekti i legjitimuar aktivisht në padi, i legjitimuar edhe në të drejtën e ankimit, jashtë kushteve ndaluese të nenit 45 të ligjit nr. 49/2012 (vendimet e paankimueshme).

Në funksion të analizës së shkaqeve të ngritura në ankim, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës nr.46 datë 21.01.2015, objekt ankimi, është rrjedhojë e një procesi të rregullt ligjor të zhvilluar në respektim të dispozitave procedurale dhe është marrë në zbatim të drejtë të ligjit material në raport me faktet dhe provat objekt gjykimi dhe si i tillë duhet lënë në fuqi.

Siç ka arsyetuar dhe Gjykata e Shkallës së Parë kërkimet e paditësit në objektin e padisë në shqyrtim, kanë të bëjnë në thelb me gjë të gjykuar.

Konkretisht me padinë në gjykim, pala paditëse ka kërkuar: *1.Shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ, vendim nr.245 datë 12.12.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Sherbimeve të Transportit Rrugor Tiranë.2.Detyrimi i pales se paditur te me ktheje ne vendin e meparshem te punes.3 Detyrimi i pales se paditur te me demshperbleje me pagesen e nje viti pune per shkak te zgjidhjes se kontrates se maredhenies se punes pa shkaqe te arsyeshme (motiv abuziv).* Këto kërkime pala paditëse i ka kërkuar me bazë ligjore nenin 146 të Kodit të Punës, që referon në shkaqet abusive të zgjidhjes së kontratës së punës.

Rezulton e provuar nga fashikulli i dosjes me nr.925 rregjistri themeltar datë rregjistrimi 31.03.2014, se paditësi [REDAKTUAR] ka paraqitur kerkesepadi ne Gjykatën Administrative të Shkalles se Pare Durrës. Kjo e fundit si ka shqyrtuar çështjen me vendim përfundimtar nr.554 06.05.2014 ka vendosur rrezjimin e padise. Ky vendim ka marre forme te prerë më date 21.05.2014. Referuar fashikullit të kësaj dosje, e cila i është bashkëlidhur fashikullit të dosjes, objekt shqyrtimi rezulton se objekti të jetë i njëjtë me atë të padisë në gjykim, pavarësisht shkaku ligjor, që në këtë gjykim është prezantuar ndryshe nga pala paditëse nëpërmjet nenit 146 të Kodit të Punës(që referon në shkaqet abusive të zgjidhjes së kontratës së punës). Por është fakt se në kërkesë padinë në gjykim rezulton të jenë paraqitur të njëjta

akte, shkaqe dhe fakte si në gjykimin e parë, konflikt i cili rezulton të jetë zgjidhur tashmë me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Ne keto kushte, me të drejtë nga gjykata e shkallës së parë, është vlerësuar se vendimi është i formes se prerë dhe çështja konsiderohet e mbyllur ne baze te parimit te gjese se gjykuar. Sipas nenit nenit 451/a te K.Pr.Civile vendimi qe ka mare forme te prerë dhe ka zgjidhur nje konflikt, nuk mund te gjykohe perseri. *Bazuar në nenin 451/a te K.Pr.Civile, autoriteti, fuqia e gjese se gjykuar, ne kuptimin substancial, te vendimit gjyqesor te formes se prerë percakton detyrueshmerine dhe pakundershtueshmerine e permbajtjes se vendimit te themelit te dhene nga gjykata, ne ate proves por edhe ne gjykime te tjera ne te ardhmen. Gjeja e gjykuar ne kuptimin substancial kuptohet si nje gjendje juridike jo thjesht pamundesie nga palet ndergjyqese te treguara ne vendimin gjyqesor te formes se prerë per te rihapur shqyrtimin e çështjes, por edhe si nje e drejte e seciles prej tyre per te kundërshtuar mundesine e rishikimit te zgjidhjes se dhene per konfliktin ne nje gjykim te ri (exceptio rei iudicatae).*

Ne kete menyre, ne interpretim e zbatim te ligjit, vendimi gjyqesor i formes se prerë qe ka zgjidhur çështjen ne themel, perben nje zgjidhje te natyres perfundimtare dhe te qendrueshme te asaj mosmarreshjeje si ne kuptimin kostitutiv ashtu edhe ne ate prekluziv. Ne kuptimin kostitutiv vendimi jep zgjidhjen perfundimtare te mosmarreshjes, pozitive te kunderta te paleve ne ate gjykim, ndersa ne kuptimin prekluziv, ndalohet mundesia e kerkimit ne gjykate te ndryshimeve ne zgjidhjen e mosmarreshjes se percaktuar me vendimin gjyqesor te formes se prerë. Pra, autoriteti, efektet e gjese se gjykuar jane perfundimi i proçesit civil dhe pamundesia (prekluziviteti) e te njejtave pale ndergjyqese per t'i kerkuar gjykates qe te shqyrtoje dhe vendose perseri mbi te njejtin objekt gjykimi (*res iudicata est*).

Ne kuptimin objektiv, gjeja e gjykuar formesohet dhe qendron ne lidhje me te njejtin objekt te padise dhe te njejtin shkak ligjor (*causa petendi*) te saj. Ne kuptimin subjektiv, gjeja e gjykuar formesohet dhe qendron ne lidhje me faktin qe, ajo qe eshte vene ne bisedim (kerkimet, pretendimet, prapesimet) sipas parimit te kontradiktoritetit dhe qe eshte vendosur ne gjykim me ane te urdherimeve te vendimit, eshte e detyrueshme indermjet paleve ndergjyqese ne ate gjykim, trashegimtare e tyre dhe personat qe kanë të drejta nga palet. Pra, ndonese vendimi duhet te njihet dhe respektohet nga te tjerët edhe efektet e tij te detyrueshmerise nuk mund te shtrihen tek te tretet qe nuk kane qene palë ndergjyqese ne ate gjykim (*res inter alios iudicatis aliis non praeiudicare*).

Në këtë menyre, vendimi gjyqesor i formes se prerë formeson vullnetin. zbatimin e ligjit, normave te tij, qe parashikojne rregullimin e marredhenieve, pra edhe te narreshjes objekt gjykimi. Ekzistenca e gjese se gjykuar ne kuptimin substancial,themelit) ben te pakundershtueshem dhe ndalon rishqyrtimin ne te ardhmen te nbajtjes se ketij vullneti te ligjit te shprehur ne vendimin e dhene nga gjykata per ate narreshje. Vullneti i ligjit qe disiplinon, rregullon marredheniet ndermjet paleve steai qe deklarohet, vendoset nga gjykata. Prandaj, pasi vendimi gjyqesor nuk mund te rishikohet me ne proçesin civil ku ai eshte dhene, permbajtja e tij behet e detyrueshme; nuk ka me vend per rishqyrtim ne kuptim te zgjidhjeve te dhena ne themel nga ai cndim. qofte kjo edhe ne çështje te tjera gjyqesore ne te ardhmen. Arsyetja, mjete juridik, hepermjet te cilit ligji mbeshet dhe percakton ndershtueshmerine e asaj qe vertetohet dhe disponohet me vendimin e formes se jre. eshte efekti prekluziv, ndalues, per ringritjen dhe perseritjen e parashtrimit ne gjykatë te kerkimeve e prapesimeve te bera apo qe mund e duhet te ishin bere rreth mosmarreshjes gjate gjykimit dhe, per te cilat, gjykata. perfundimisht. ka vendosur në vullnet te ligjit.

Efeki, fuqia e gjese se gjykuar mbulon jo vetem pjesen urdheruese te vendimit gjyqesor te formes se prere, me te cilen gjykata ka vendosur njohjen e se drejtes se njeres mbi objektin e mosmarreveshjes. ***Ky efekt, autoritet, mbulon edhe rrethanat e çështjes te pranuar ne gjykim, perfundimet e arsytet ne te cilat eshte mbeshtetur ai vendim ne pjesen arsyetuese dhe qe kane lidhje me ate qe urdheron gjykata ne dispozitivin e vendimit te saj.***

Nese ne nje gjykim te ardhshem, shtrohen per diskutim e shqyrtim çeshtje te proves apo te se drejtes qe kane lidhje thelbesore me çeshtjet per te cilat eshte dhene nje vendim gjyqesor i formes se prere, pra me ato çeshtje qe ka çmuar, pranuar dhe urdheruar gjykata ne ate vendim, edhe kur aty ka pale ndergjyqese, objekt dhe shkak ligjor te ndryshem nga ai i vendimit gjyqesor qe ka marre forme te prere apo edhe nese ne dukje mund te parashtrohen si kerkime per here te pare, atehere prekludohet (ndalohe) rivenia ne bisedim, shqyrtimi gjyqesor i ketyre çeshtjeve. Pra, per keto çeshtje te shqyrtuara e vendosura ne gjykime te meparshme gjen zbatim parimi i gjese se gjykuar. Ne te njejten menyre duhet te trajtohet edhe rasti kur objekti i padise dhe shkak ligjor jane te njejta, po keshtu edhe palet, por, keto pale invertojne poziten e tyre p.sh nga i paditur ne padites, etj., sepse ne kete rast identiteti i tyre juridik (jo ai material) konsiderohet i njejte me ate te gjykimit te meparshem.

Në të njëjtën mënyrë duhet te trajtohet edhe rasti kur ne gjykim është i njejti dhe shkak ligjor padie, te njejta pale por jane pakesuar disa prej paleve apo jane pale te tjera qe nuk kane gene ne gjykimin kur vendimi ka marre forme te prere. Identiteti i paleve te reja mund te jete i ndryshem ne kuptimin material (fizik) por është njëjtë ne ate juridik, sepse behet fjale per pale "te perfaqesuara" ne gjykim (trashegimtare qe heqin te drejta me palen ndergjyqese). Po ne te njejten menyre trajtohet edhe rasti identiteti fizik dhe juridik i pales se thirrur ne cilesine e te paditurit apo personit të tretë në gjykimin e mevonshem nuk është i njejte me asnje prej atyre te gjykimit te themelit, por ne kete gjykim te mevonshem jemi perpara te njejtit objekt dhe shkak ligjor te padise.

Ne procesin civil, gjeja e gjykuar mbulon jo vetem kerkimet, por edhe prapesimet parashtuara apo qe mund dhe duhet te ishin parashtuar per te kundërshtuar faktet konstituive të së drejtës së pretenduar ne gjykim nga ana e paditesit apo kunderpaditesit. autoriteti, fuqia e gjese se gjykuar, mbulon jo vetem kerkimet e prapesimet e hera te gjykimit (e njohur si *autoriteti i gjese se gjykuar te shprehur*), por edhe te gjitha ato që mund dhe duhet te beheshin me ane te ngritjes se padise, kunderpadise dhe prapësimeve, te cilat ndonese te patrajtuara ne vendimin e formes se prere, prezumohen se bëjnë pjese ne menyre te pashmangshme ne logjiken juridike te arsytimit, te përfundimeve dhe urdherimeve te vendimit gjyqesor te formes se prere (e njohur si *autoriteti i gjese se gjykuar te heshtur. te nenkuptuar*)..".

Duke marrë në analizë rastin në gjykim si dhe pretendimet e paleve ndërgjyqëse në gjykim, çështja objekt shqyrtimi gjyqesor përbën gjithë të gjykuar në kuptimin formal dhe material. kjo për faktin se si nga ana formale ashtu edhe përmbajtja e saj. në thelb në këtë gjykim janë paraqitur për zgjidhje të njëjtat shkaqe dhe pretendime që janë paraqitur në gjykimin e parë. që është zgjidhur me vendim të formës së prerë.

Në analizë të sa më sipër, Gjukata Administrative e Apelit bazuar në nenin 50. shkronja "b" të ligjit nr.49/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative*" i ndryshuar, përfundimisht vlerëson se nuk ka shkaqe për të ndryshuar vendimin nr.46 datë 21.01.2015 të Gjukatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe si të tillë vendos lënien në fuqi të tij.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 50, shkronja "c" e ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar

VENDOSI :


- Lënien në fuqi të vendimit nr.46 datë 21.01.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.
- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, brenda 30 ditëve afat që fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.

-U shpall sot në Tiranë me date 21.11.2016

GJYQTAR
BERNINA KONDI



GJYQTAR
ALTINA NASUFI



GJYQTAR
KASTRIOT SELITA



